



PROCESVERBAL I/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 28.01.2022
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyqi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Besa Kuçi

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Enver Shabani

Z. Driton Maliqaj

Z. Xhevxhet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Znj.Festë Kabashi

Z.Herolind Limaj

Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.X heladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi .

REND DITE

1. **Dhënia e deklaratës së betimit të anëtarëve që janë zëvendësuar;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale „Stacioni i Autobusëve” SH.A;**
4. **Shqyrtimi projekt-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për studentë/e dhe nxënës/e të Komunës së Suharekës;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2022;**
7. **Shqyrtimi projekt-vendimit për miratimin e planit të punës të Kuvendit të Komunës në Suharekë,për vitin 2022 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës ,Komitetit për Politikë dhe Financa,Komitetit për Komunitetet për vitin 2022;**
8. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-410-76547,të datës 14.12.2021;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit,i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika1. Dhënia e deklaratës së betimit të anëtarëve që janë zëvendësuar;

Mimoza Bajraktari dhe Saranda Bajraktari japin deklaratën e betimit.

Pika 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Urim Suka - kemi vërejtje te pjesa e fundit, për pyetjet apo qështjet që janë shtruar,thuhet: Kryetari jep përgjigje.Le të jetë përgjigjja që e ka thënë Kryetari.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB);

Kryesuesi - elaboron këtë pikë dhe thotë se është bërë një zëvendësim te përfaqësuesja e KLSP-së. Në vend të Ketjana Muça është propozuar Drilon Zyba.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit. Ne si LDK në parim e mbështesim. Në këtë projekt-vendim vërehet një tendencë e Kryetarit për të emruar të dëgjuarit e tij. Te propozimi i përfaqësueses shqipëtare Mërvete Shalës, me çfarë kritere është zgjedhur? Sipas disa informatave Mërvete Shala ka qenë kandidatë për Asamble. Kërkoj sqarime. Deri tash kemi pa tendencë të Kryetarit, më shumë me bo foto, por përmbajtje nuk kemi pa. Vet fakti i dukurive të fundit negative. E mbështesim këtë këshill dhe kërkojmë angazhim maksimal për parandalimin e dukurive negative.

Laureta Tafaj - përshëndet të pranishmit. Znj. Herolinda Zenelaj, cilat media i përfaqëson?

Kryesuesi - Mërvete Shala është nga Mushtisht. Në seancat e radhës kur të kemi diçka me debat për KKSBB, ke arsye me debat për këto që i theksojmë tani po e formojmë KKSBB-në.

Urim Suka - unë kërkoj sqarime nga Kryesuesi ose nga Kryetari. A është kandidatja juaj për Asamble e caktuar për mi përfaqësu shqipëtarët.

Kryesuesi - nuk është, por ka qenë.

Urim Suka - mendoj që qasja është gabim dhe ju kisha lut me ndryshu, sepse kandidatja që e keni pas për Asamble nuk mundet mi përfaqësu gjithë shqipëtarët.

Avni Bytyqi - zyrtar ligjor jep sqarime shtesë rreth procedurës së emërimit për KKSBB-në. Sa i përket qështjes se a ka qenë kandidatë për Asamble është qështje e Kryetarit për me sqaru.

Urim Suka - nuk kam asgjë kundër Myrvete Shalës. Ju lus ta ndërroni këtë propozim dhe t'na jepni mundësin për me votu për.

Kryesuesi - e hedhë në votim.

22 për, 8 kundër, Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale „Stacioni i Autobusëve” SH.A;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë se duhet të jenë tre anëtar të zgjedhur nga Kuvendi. Kërkon nga subjektet politike ti japin emrat.

Laureta Tafaj - a mund të na tregoni mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të Kuvendit, a do të votohet në paketë për ta, apo do votohet veq e veq secili propozim ?

Kryesuesi - njëherë marrim propozimet, pastaj votohet veq e veq.

Urim Suka - më shqetëson qasja, sepse këtë qasje e keni pas edhe me miratimin buxhetit. Sot ne po themi me hek një përfaqësuese që është kandidatë e juaja, dhe ju po doni me përdor arrogancën e numrave. Ne e dim që i keni numrat edhe me formu komisionin e aksionarëve për stacionin e autobusave. Ne kërkojmë që secili prej partive politike ti ketë përfaqësuesit e vet. Një të jetë nga pozita, një nga opozita dhe një nga ekzekutivi dhe të miratohet në paketë. Ju lus dhe njëherë, edhe juve si Asamble që ta ndërrojmë këtë qasje. Meqë është ndërmarrje publike, mos ta kthejmë në ndërmarrje të një koalicioni, por ta kthejmë në ndërmarrje të Kuvendit dhe të funksionojë ajo ndërmarrje sa ma mirë.

Kryesuesi - dy propozohen nga Kuvendi dhe të tretin e propozon Kryetari. Kërkoj nga subjektet politike dy propozime.

Aziz Bytyqi - në emër të AAK-së propozoj z. Reshat Selimaj.

Laureta Tafaj - Kryesues, ju thatë që kërkon dy emra, dhe më herët the se mundemi me pas më shumë propozime, pastaj votohet.

Kryesuesi - jepni propozimet e juaja, por dy do të shkojnë.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. PDK propozon Sheqerije Zyrapin.

Kryetari - propozon Xhevdet Gashin.

Kryesuesi - e hedh në votim si pako pasi kemi veq tre emra të propozuar.

Shefket Kolgeci - ju thatë paketë nuk bën ,dhe kjo është paketë nëse i votoni dytë.

Kryesuesi - unë e cekta ,nëse do të ishte edhe një propozim më shumë,atëherë do të votonim veq e veq.

Avni Bytyqi - Kryesuesi e tha, që keni të drejtë të gjitha subjektet politike me propozu.Pra nëse kalojnë më tepër se tre kandidatë të propozuar,ne obligohemi që ti votojmë një nga një.

Shefket Kolgeci - nuk pajtohet me këtë mënyrë të votimit.

Alban Berisha - përshëndet të pranishmit.Ligjshmëria i jep të drejtë atij që ka shumicën e votave,por është një praktikë që ka qenë historikisht në Asamble,që çdo komision e ka përbë pozita sëbashku me opozitën.Pra nuk shkelet ligji por praktika gjithëpërfshirëse.

Urim Suka - tendenca juaj është për çdo keqardhje.Ne dëshirojmë ta propozojmë një kandidatë tonin.Propozojmë Flamur Bytyqin.

Laureta Tafaj - ne e mbështesim propozimin e LDK-së dhe kërkoj nga të gjithë ta mbështesni pasi duhet me qenë dikush nga opozita,pasi që AAK dhe PDK janë në koalicion.

Kryesuesi - e hedhë në votim anëtarin e propozuar Reshat Selimaj.

20 për, 9 kundër, kalon

Kryesuesi - e hedh në votim anëtaren e propozuar Sheqerie Zyrapi.

17 për, 12 kundër, kalon

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Flamur Bytyqin.

13 për, 16 kundër, 1 apstenim, nuk kalon

Kryesuesi - i hedh në votim si pako Reshat Selimaj,Sheqerie Zyrapi dhe Xhevxhet Gashi.

18 për, 12 kundër
Miratohet pika 4.

Shefket Kolgeci - unë i propozoj grupit tim parlamentar që mbas kësaj mbledhje të mos marrim pjesë në Asamblenë Komunale si grup paralametar i LDK-së.

Pika 5. Shqyrtimi projekt-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për studentë/e dhe nxënës/e të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe kërkon nga subjektet politike propozimet e tyre.

Aziz Bytyqi -në emër të grupit parlamentar të AAK-së propozoj Jehona Rrafshin.

Bulëza Kuçi - në emër të grupit parlamentar të LDK-së propozoj Elmaze Bytyqin.

Dardan Berisha - në emër të grupit parlametar të PDK-së propozoj Bajram Basha.

Laureta Tafaj - në emër të grupit parlamentar të LVV-së propozoj Qëndrim Elshani.

Urim Suka - këtë pjesën tash nuk e pritëm.Ju i propozuat dy dhe dy pastaj Kryetari.

Kryesuesi - dy shkojnë prej ekzekutivit.

Driton Maliqaj - jep sqarime dhe thotë se janë ligjet dhe udhëzimet administrative të cilat e përcaktojnë zgjedhjen e komiteteve dhe të komisioneve.Andaj po bëhet debat për diçka të panevojshme.

Bulëza Kuçi - herën e kaluar ka qenë praktikë që në bazë të votave, partitë politike për shumicën që e kan këtu.Domethënë AAK-ja,pastaj LDK-ja dhe pastaj partitë tjera.Ju po vazhdoni me një praktikë edhe më të keqe se para 4 viteve.

Laureta Tafaj - dua ti them Dritonit që nuk mundesh me na mohu të drejtën e diskutimit.

Kryesuesi - e hedh në votim anëtaren e propozuar Jehona Rrafshi.

18 për, 12 kundër

Kryesuesi - e hedh në votim anëtaren e propozuar Elmaze Bytyqi .

21 për, 1 kundër, 4 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Bajram Basha.

18 për, 12 kundër

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Qëndrim Elshani.

14 për, 14 kundër, 2 apstenime

Kryetari - propozon nga ekzekutivi **Sahadete Kuçi dhe Agim Rraqi.**

Kryesuesi - në këtë komision janë: **Jehona Rrafshi-Lumi, Elmaze Bytyqi, Bajram Basha, Agim Rraqi dhe Sahadete Kuçi.**

Kryesuesi - e hedh në votim si pako.

19 për, 11 apstenime

Miratohet Pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën 6 dhe thotë se komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve. Dy anëtar vin nga Kuvendi, dy nga ekzekutivi dhe një nga sektori jo-qeveritar. Kërkon propozimet.

Aziz Bytyqi - në emër të AAK-së propozoj Driton Maliqaj.

Urim Suka - ne propozojmë Kushtrim kuçi.

Dardan Berisha - ne propozojmë Mevlude Kabashi.

Qendrim Elshani - propozojmë Laureta Tafaj.

Kryesuesi - e heh në votim anëtarin e propozuar Driton Maliqaj.

18 për, 11 kundër, 1 apstenim

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Kushtrim Kuçi.

12 për, 18 kundër

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Mevlude Kabashi.

18 për, 12 kundër

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Laureta Tafaj.

14 për, 12 kundër, 3 apstenime

Kryetari - propozon **Armend Krasniqi, Visar Kuçi dhe Suzana Gashi.**

Shefket Kolgeci - asnjëherë s'ka ndodh, që 20 vite pluralizëm, në këtë komision, të mos jenë të gjitha partitë politike që marrin pjesë në Asamble. Kjo është autokracia.

Urim Suka - kjo qasje është shqetësuese për demokracinë, është shqetësuese për zhvillimin e Komunës. Te komisioni i pronave, ku juve ju intereson më së shumti, janë krejt përfaqësuesit e juaj. Ju bëj thirrje secilit qytetar që ta dëgjoj zërin tonë sepse logjika që po instalohet është logjika prejashuese edhe e opozitës edhe e qytetarëve.

Dardan Berisha - ne jemi në bashkëqeverisje. Kemi pas ofertë edhe nga LDK që tash bëjnë zhurmë. Sa i përket këtij komisioni, në legjislaturën 2017-2021 me sa e di kanë qenë 5 anëtar të propozuar nga Kuvendi. A ka ndryshu rregullorja.

Aziz Bytyqi - të pretendosh të eliminosh instrumentin kryesor në demokraci që është vota, ajo është e papranueshme. Ne nuk kemi formë tjetër përveç se ti nënshtrohemi votës. Ne po japim vote politike dhe nuk po japim vote miqësore. E di që ndoshta nuk është e pëlqyeshme, por demokracia kështu funksionon.

Kryesuesi - në këtë komision janë:**Driton Maliqaj, Mevlude Kabashi, Armend Krasniqi, Visar Kuçi dhe Suzana Gashi.**

Kryesuesi - e hedh në votim si pako.

**18 për, 12 kundër
Miratohet Pika 6**

Bulëza Kuçi - këto praktika s'kan qenë asnjëherë. Kryetar, a ndihesh krenar me këtë praktikë dhe me këtë gjendje.

Kryetari - vetëm jam duke i zbatuar ligjet dhe rregulloret që janë në fuçi.

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pike dhe hap debatin. Nuk ka debat.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës të Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2022 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitetet për vitin 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe e hedh në votim.

29 për, 1 apstenim, Miratohet

Pika 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-410-76547, të datës 14.12.2021;

Kryesuesi - kemi një ndryshim në Komitetin për Politikë dhe Financa. Është tërhek një anëtare e AAK-së. Kërkoj nga grupi i AAK-së të japin propozimin për zëvendësim.

Aziz Bytyqi - propozojmë Fidaije Kukaj.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 9.

Unanimisht Miratohet

Shefket Kolgeci - nuk është pika e rendit të ditës; pyetje dhe përgjigje. Propozoj që mbledhjet e ardhshme të jetë kjo pike.

Takimi përfundoi: 11:15

Procesmbajtësja
Dafina Haziraj